



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1860 / 4 prot

Datë 27.10.2021

V E N D I M

Nr. 812/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.10.2021 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes së ankeses së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-06853-09-30-2021 me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi/Natriumi”, me fond limit 1,205,000 lekë pa TVSH, publikuar në datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime SH.A Dimal.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime SH.A Dimal
Adresa: Rruga “Djaloshi i Dimalit”, Lagjja “18 Tetori”, Dimal.

Ankimues: “Albania Distribution Chemicals” SHPK
Adresa: Rruga “Kavajës”, Buka SH.A, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.10.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-06853-09-30-2021 me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi/Natriumi”, me fond limit 1,205,000 lekë pa TVSH, publikuar në datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime SH.A Dimal.

II.2. Në datën 04.10.2021 operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1860/2 prot datë 11.10.2021, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 161 prot datë 14.10.2021 dhe shkresës nr. 6298/2 prot, datë 20.10.2021 me objekt: “Kthim-përgjigje”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 1860/3 prot datë 22.10.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni si dhe kthim-përgjigjja e autoritetit kontraktor lidhur me pretendimet e ankimesit për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankësën e operatorit ekonomik ankimes dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

Në lidhje me kriterin e përcaktuar në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.b “Kapaciteti teknik”, “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e OHSAS 18001-2007 mbi ”Sistemin e drejtimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” / ose ekuivalent”

Konkretisht ankimesi ka kërkuar heqjen e kriterit të vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit, lidhur me “OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e drejtimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” ose ekuivalente. AK nuk është autoritet përgjegjës për të kontrolluar sigurinë e punonjësve në mjediset e shoqëritë, këto funksione i kryen inspektorati i Punës që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, thënë kjo, argumentojmë se ky certifikim nuk lidhet me objektin e prokurimit, përkundrazi nëpërmjet këtij certifikimi AK tejkalon kompetencat e tij. Lidhur me kushtet e magazinimit argumentojmë se OE i cili nuk e importon mallin objekt prokurimi, por e siguron brenda vendit, nuk është i detyruar të pajiset me këtë certifikatë, pasi ai e merr mallin direkt nga magazina e furnitorit vëndas drejt magazinës së AK, duke përjashtuar mundësinë për të patur në magazinë. Certifikata OHSAS 18001:2007 ose ekuivalente e saj, garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie, e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve. Në rastin konkret referuar objektit të prokurimit mund të marrin pjesë përveç kompanive prodhuese të cilat e kanë të detyrueshme certifikimin me OHSAS 18001:2007 edhe kompani të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre vetëm tregtimin e produkteve objekt-prokurimi. Në këtë kuptim gjykojmë, se për shoqëritë të cilat kanë për objekt veprimtarie vetëm tregtimin e produkteve që do të prokurohen nuk kanë domosdoshmërisht detyrimin të pajisen me certifikatë OHSAS 18001:2007”, [...] ky kriter është diskriminuese dhe duhet të hiqet.”

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor me shkresën nr 159 prot, datë 07.10.2021 rezulton se ankesa është pranuar si vijon:

“[...] Njësia e Prokurimit ka vendosur modifikimin e kriterëve si më poshtë: Për kapacitetin teknik:

ISHTE: *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën OHSAS 18001-2007 mbi "Sistemin e drejtimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë" / ose ekuivalent.*

BËHET: *Ky Kriter Hiqet.*

Në lidhje me kriterin e përcaktuar në shtojcën 7/2 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 2.3.b "Kapaciteti teknik", "*Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet Bot që do të shërbejë për transportin e lëndës Hipoklorit Natriumi, në pronësi të tij ose të marrë me qera. Kjo të vërtetohet me dokumentacionin\; Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë Transporti për Mallrat e Rrezikshëm, certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracioni mjetit, Kolaudimi mjetit. Kur mjeti është me qera të paraqesë: Kontratën e qerasë, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kontrolli teknik (kolaudimi)".*

Konkretisht ankimuesi ka kërkuar heqjen e kriterit të vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit, lidhur me "*Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet Bot, që do të shërbejë për transportin e lëndës Hipoklorit Natriumi, në pronësi të tij ose të marrë me qira. Kjo të vërtetohet me dokumentacionin\; Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë Transporti për Mallrat e Rrezikshëm, certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracioni mjetit, Kolaudimi mjetit. Kur mjeti është me qira të paraqesë: Kontratën e qirasë, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kontrolli teknik (kolaudimi)". Për sa i përket këtij kriteri malli objekt-prokurimi, hipoklorit natriumi sigurohet nga ana jonë, nga furnitori me depozita 1200 kg të vendosura në makinë transporti dhe nuk është detyrim i nevojshëm transporti i këtij malli me Autobot. Ky mall mund të transportohet si e përmendëm më sipër dhe me depozita 1200 kg dhe mund t'jua sigurojmë sipas grafikut tuaj. Më poshtë gjeni të demonstruar me foto mallin e lartëpërmendur të transportuar me depozita 1200 kg nga furnitori jonë. Për sa i përket automjetit për transportin e hipoklorit kalciumi ne si OE mendojmë se ky kriter cenon nenin 2 të LPP, AK mund ta kërkojë këtë kontratë ti paraqitet vetëm në momentin kur OE shpallet fitues dhe jo përpara hedhjes së kësaj procedure. Kërkojmë që ky kriter të hiqet".*

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor me shkresën nr 159 prot, datë 07.10.2021 rezulton se ankesa është pranuar si vijon:

ISHTE: *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet që do të shërbejë për transportin e mallit Hipoklorit Kalciumi, në pronësi të tij ose të marra me qira për transportin e mallrave objekt prokurimi. Kjo të vërtetohet me dokumentacionet: Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kolaudimin, NIPT i mjetit, foto të mjetit. Kur mjeti është me qira të paraqesë: Kontratën e qerases, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kontrolli teknik (kolaudimi), NIPT i mjetit, foto të mjetit.*

Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet Bot që do të shërbejë për transportin e lëndës Hipoklorit Natriumi, në pronësi të tij ose të marrë me qira. Kjo të vërtetohet me

dokumentacionin\; Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë Transporti për Mallrat e Rrezikshëm, certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracioni mjetit, Kolaudimi mjetit. Kur mjeti është me qira të paraqesë: Kontratën e qerasë, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracioni i mjetit (TPL), kontrolli teknik (kolaudimi).

BËHET: Ky Kriter Hiqet.

Në lidhje me kriterin e përcaktuar në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.b “Kapaciteti teknik”, “Fletë Analize e lëshuar nga Organet kompetente të autoriteteve shqiptare nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) Tiranë që vërteton cilësinë e lëndës dezinfektante të kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentet standarde të tenderit për Hipoklor Kalciumi 60-65 %, Natriumi 12-15 %. Vlefshmëria e Flet Analizës të jetë jo më vonë se tre muaj nga dita e tenderit”.

Konkretisht ankimuesi ka kërkuar heqjen e kriterit të vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit, lidhur me “Fletë Analize e lëshuar nga Organet kompetente të autoriteteve shqiptare nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) Tiranë që vërteton cilësinë e lëndës dezinfektante të kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentet standarde të tenderit për Hipoklor Kalciumi 60-65 %, Natriumi 12-15 %. Vlefshmëria e Flet Analizës të jetë jo më vonë se tre muaj nga dita e tenderit”. Lidhur me këtë kriter kërkojmë t’ju bëjmë me dije se Instituti i Shëndetit Publik prej disa kohësh nuk mund të ofrojë shërbimin e saj për analizat toksikologjike (metalet e rënda) për mallin objekt prokurimi. ISHP i kontaktuar nga ana jonë më datë 17.06.2021 me nr. prot. 781, na ka kthyer zyrtarisht përgjigjen më datë 25.06.2021, nr. prot 781/1 ku ndër të tjera thuhet se “aktualisht është e pamundur kryerja e analizave për shkak të mosfunksionimit të aparaturës analizuese në laboratorin e kimisë analitike instrumentale”. Po ashtu në datë 24.08.2021 me Nr. prot 1074 i kemi dërguar përsëri shkresë dhe na është kthyer në datën 01.09.2021 me Nr. prot 1074/1 kur ndër të tjera thuhet se “ këto tregues nuk mund të kryhen përkohësisht në laboratorin tonë për shkak të një defekti në aparaturë”. Në këto kushte ne i jemi drejtuar Drejtorisë Rajonale Tiranë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, për të bërë Analizat për Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi ku kemi marrë përgjigje se janë brenda standardeve të Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu kërkojmë që ky kriter të hiqet sepse Analiza që kryhet te ISHP bëhet njëherë në 3 muaj duke dorëzuar një mostër për secilin produkt, ndërsa malli që dërgohet tek AK është diçka tjetër ku çdo AK është i detyruar që përpara marrjes në dorëzim të mallit të thërras Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale përkatëse për çdo qytet për të bërë Analizat e Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi në qoftë se janë brenda normave të kërkuara. Pra Analizat e bëra pranë ISHP nuk merren parasysh në momentin e dorëzimit të mallit. Kërkojmë që ky kriter të hiqet”.

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 159 prot, datë 07.10.2021 rezulton se ankesa është pranuar si vijon:

ISHTE: *Fletë-Analize e lëshuar nga Organet kompetente të autoriteteve shqiptare nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) Tiranë që vërteton cilësinë e lëndës dezinfektante të kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentet standarde të tenderit për Hipoklor Kalciumi 60-65 %, Natriumi 12-15 %.*

Vlefshmëria e Flet Analizës të jetë jo më vonë se tre muaj nga dita e tenderit.

BËHET: *Autoriteti ynë Kontraktor për çdo ngarkesë malli që do marrë nga operatori ekonomik i shpallur fitues do të çojë mostër për analizë, pranë ISHP BERAT.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimesit për heqjen e kërkesës së vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit lidhur me:

- 1- *“OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e drejtimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” ose ekuivalente. AK nuk është autoritet përgjegjës për të kontrolluar sigurinë e punonjësve në mjediset e shoqëritë, këto funksione i kryen inspektoriati i Punës që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, thënë kjo argumentojmë se ky certifikim nuk lidhet me objektin e prokurimit përkundrazi nëpërmjet këtij certifikimi AK tejkalon kompetencat e tij. Lidhur me kushtet e magazinimit argumentojmë se OE i cili nuk e importon mallin objekt prokurimi por e siguron brenda vendit, nuk është i detyruar të pajiset me këtë certifikatë, pasi ai e merr mallin direkt nga magazina e furnitorit vendas drejt magazinës së AK duke përjashtuar mundësinë për të patur në magazinë. Certifikata OHSAS 18001:2007 ose ekuivalente e saj garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve. Në rastin konkret referuar objektit të prokurimit mund të marrin pjesë përveç kompanive prodhuese të cilat e kanë të detyrueshme certifikimin me OHSAS 18001:2007, edhe kompani të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre vetëm tregtimin e produkteve objekt prokurimi. Në këtë kuptim gjykojmë se për shoqëritë të cilat kanë për objekt veprimtarie vetëm tregtimin e produkteve që do të prokurohen nuk kanë domosdoshmërisht detyrimin të pajisen me certifikatë OHSAS 18001:2007”, [...] ky kriter është diskriminues dhe duhet të hiqet”.*
- 2- *“Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet Bot që do të shërbejë për transportin e lëndës Hipoklorit Natriumi, në pronësi të tij ose të marrë me qira. Kjo të vërtetohet me dokumentacionin\; Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë Transporti për Mallrat e Rrezikshëm, certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit, Kolaudimi mjetit. Kur mjeti është me qira të paraqesë: Kontratën e qirasë, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL),*

kontrolli teknik (kolaudimi)”. Për sa i përket këtij kriteri malli objekt-prokurimi, hipoklorit natriumi sigurohet nga ana jonë nga furnitori me depozita 1200 kg të vendosura në makinë transporti dhe nuk është detyrim i nevojshëm transporti i këtij malli me Autobot. Ky mall mund të transportohet si e përmendëm më sipër dhe me depozita 1200 kg dhe mund t’jua sigurojmë sipas grafikut tuaj. Më poshtë gjeni të demonstruar me foto mallin e lartëpërmendur të transportuar me depozita 1200 kg nga furnitori jonë. Për sa i përket automjetit për transportin e hipoklorit kalciumi ne si OE mendojmë se ky kriter cenon nenin 2 të LPP, AK mund ta kërkojë këtë kontratë ti paraqitet vetëm në momentin kur OE shpallet fitues dhe jo përpara hedhjes së kësaj procedure. Kërkojmë që ky kriter të hiqet”.

- 3- “Fletë-Analize e lëshuar nga Organet kompetente të autoriteve shqiptare nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) Tiranë, që vërteton cilësinë e lëndës dezinfektante të kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentet standarde të tenderit për Hipoklor Kalciumi 60-65 %, Natriumi 12-15 %. Vlefshmëria e Fletë Analizës të jetë jo më vonë se tre muaj nga dita e tenderit”. Lidhur me këtë kriter kërkojmë t’ju bëjmë me dije se Instituti i Shëndetit Publik prej disa kohësh nuk mund të ofrojë shërbimin e saj për analizat toksikologjike (metalet e rënda) për mallin objekt-prokurimi. ISHP i kontaktuar nga ana jonë më datë 17.06.2021 me nr prot. 781, na ka kthyer zyrtarisht përgjigjen më datë 25.06.2021, nr. prot 781/1, ku ndër të tjera thuhet se, “aktualisht është e pamundur kryerja e analizave për shkak të mosfunksionimit të aparaturës analizuuese në laboratorin e kimisë analitike instrumentale”. Po ashtu në datë 24.08.2021 me Nr. prot 1074 i kemi dërguar përsëri shkresë dhe na është kthyer në datën 01.09.2021 me Nr. prot 1074/1, kur ndër të tjera thuhet se “ këto tregues nuk mund të kryhen përkohësisht në laboratorin tonë për shkak të një defekti në aparaturë”. Në këto kushte ne i jemi drejtuar Drejtorisë Rajonale Tiranë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, për të bërë Analizat për Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi ku kemi marrë përgjigje se janë brenda standardeve të Bashkimit Europian dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu kërkojmë që ky kriter të hiqet sepse Analiza që kryhet te ISHP bëhet njëherë në 3 muaj duke dorëzuar një mostër për secilin produkt, ndërsa malli që dërgohet tek AK është dicka tjetër ku çdo AK është i detyruar që përpara marrjes në dorëzim të mallit të thërras Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale përkatëse për çdo qytet për të bërë Analizat e Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi nëqoftëse janë brenda normave të kërkuara. Pra Analizat e bëra pranë ISHP nuk merren parasysh në momentin e dorëzimit të mallit. Kërkojmë që ky kriter të hiqet”

në bazë të ligjit të LPP 162 datë 23.12.2020 përkatësisht nenin 75 pika 2, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 161 prot datë 14.10.2021 dhe shkresës nr. 6298/2 prot, datë 20.10.2021 me objekt: “Kthim-përgjigje”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 1860/3 prot datë 22.10.2021, rezulton se ankesa është pranuar si vijon.

“ [..]Njësia e Prokurimit ka vendosur modifikimin e kriterëve si më poshtë:

Për kapacitetin teknik pika 2.3.b:

ISHTE: *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e OHSAS 18001-2007 mbi “Sistemin e drejtimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” / ose ekuivalent.*

BËHET: *Ky kriter hiqet.*

ISHTE: *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet që do të shërbejë për transportin e mallit Hipoklorit Kalciumi, në pronësi të tij ose të marra me qira për transportin e mallrave objekt-prokurimi. Kjo të vërtetohet me dokumentacionet: Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kolaudimin, NIPT i mjetit, foto të mjetit. Kur mjeti është me qira të paraqesë: Kontratën e qirasë, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kontrolli teknik (kolaudimi), NIPT i mjetit, foto të mjetit .*

Operatori ekonomik duhet të disponojë një mjet Bot që do të shërbejë për transportin e lëndës Hipoklorit Natriumi, në pronësi të tij ose të marrë me qira. Kjo të vërtetohet me dokumentacionin \; Kur mjeti është në pronësi të paraqesë: Certifikatë Transporti për Mallrat e Rrezikshëm, certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracioni mjetit, Kolaudimi mjetit. Kur mjeti është me qira të paraqesë: Kontratën e qirasë, Certifikatë transport mallrash, Certifikatë pronësie, Leje qarkullimi, Siguracion i mjetit (TPL), kontrolli teknik (kolaudimi) .

BËHET: *Ky kriter hiqet.*

ISHTE: *Fletë-Analizë e lëshuar nga Organet kompetente të autoritëve shqiptare nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), Tiranë që vërteton cilësinë e lëndës dezinfektante të kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentet standarde të tenderit për Hipoklor Kalciumi 60-65 %, Natriumi 12-15 %*

Vlefshmëria e Fletë-Analizës të jetë jo më vonë se tre muaj nga dita e tenderit.

BËHET: *Autoriteti ynë Kontraktor për çdo ngarkesë MALLI që do marrë nga operatori ekonomik i shpallur fitues do të cojë mostër për analize, pranë ISHP BERAT.*

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të*

nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 1860/3 prot datë 22.10.2021, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor SH.A Ujësjellës Kanalizime Dimal e ka pranuar tërësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

Gjithashtu rezulton, se autoriteti kontraktor SH.A Ujësjellës Kanalizime Dimal më datë 06.10.2021 ka publikuar në SPE një shtojcë, ku pasqyrohen ndryshimet e dokumenteve të tenderit, në përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-06853-09-30-2021 me objekt: “*Blerje Hipoklorit Kalciumi/Natriumi*”, me fond limit 1,205,000 lekë pa TVSH, publikuar në datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime SH.A Dimal.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Albania Distribution Chemicals*” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro